



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 817/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.12.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt, “Ndërtim rrjet furnizimi me ujë i zonës së “Bab Rexhës”, Fusha e Aviacionit”, me nr. REF-82943-08-14-2018, me fond limit 38,513,055 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 25.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k.  
Adresa: Lagjia Qesarakë, godinë banimi dhe shërbimesh 3, 4 kate, kati I, Dajt, Tiranë.

**Autoriteti kontraktor:**

Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.  
Adresa: Rr. “5 Maj”, pranë Medresesë, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 15.08.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt, “Ndërtim rrjet furnizimi me ujë i zonës së “Bab Rexhës”, Fusha e Aviacionit”, me nr. REF-82943-08-14-2018, me fond limit 38,513,055 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 25.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.

II.2 Në datën 25.09.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 02.10.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. "Alen Co" shpk,	pa ofertë ekonomike Skualifikuar;
2. "Fat Group" shpk,	pa ofertë ekonomike Skualifikuar;
3. "Eurondërtimi 2000" shpk,	26,262,806.00 lekë Skualifikuar;
4. "B-93" & "Riviera" shpk,	27,817,275.00 lekë Skualifikuar;
5. "Bonus" & "Guri Ndërtim" shpk,	28,609,697.73 lekë Skualifikuar;
6. "Dajti Park 2007" shpk,	28,983,108.00 lekë Skualifikuar;
7. "Senka" shpk,	31,965,978.00 lekë Skualifikuar;
8. "Ndregjoni" shpk,	33,592,456.00 lekë Kualifikuar;
9. "Arb & Trans 2010" shpk & "Kupa" shpk,	33,602,136.00 lekë Skualifikuar;
10. "Viante Konstruksion" shpk,	33,685,909.77 lekë Skualifikuar;
11. "Junik" shpk,	34,109,807.00 lekë Skualifikuar;
12. "Rruga Ura Asfaltim nr.2 Elbasan" & "Igor Elektrik" & "Delia Impex" shpk,	34,653,260.00 lekë Kualifikuar;
13. "Adriatik" & "Varaku - E" shpk,	36,201,120.90 lekë Kualifikuar;
14. "Be-Is" shpk,	36,508,254.00 lekë Kualifikuar;
15. "Biba - X" shpk,	39,212,508.00 lekë Skualifikuar;

II.4.Nga verifikimet e kryera, rezulton se operatori ekonomik "Dajti Park 2007" sh.p.k. është njoftuar nëpërmjet Sistemit e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsyet si më poshtë vijon:

*"3. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik Dajti Park 2007" sh.p.k. me vlerë të ofertës 28.983.108 (njëzetë e tetë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tre mijë e njëqind e tetë) lekë pa TVSH. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" I ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky operator nga ku rezultoi si më poshtë: Së pari AK, në dokumentat e Tenderit ka kërkuar si më poshtë cituar: 15.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10). Mjetet Sasia Gjendja Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjetë) ton për secilin kamion 3 copë Pronësi ose me qera Fadrome me goma 1 copë Pronësi ose me qera Eskavator me goma 0.25 m3 1 copë Pronësi ose me qera Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15(pesëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20(njëzetë) ton për secilin kamion 3 copë Pronësi ose me qera Autobetoniere 1 copë Pronësi ose me qera Autovinc 1 cope Pronësi ose me qera Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë 4 cope Pronësi ose me qera Makine per ngjitje tubash PE 1 cope Pronësi ose me qera Tokmak elektrik 1 cope Pronësi ose me qera Pompe uji 1 cope Pronësi ose me qera Matrapik 1 cope Pronësi ose me*

qera Vibrator 1 cope Pronësi ose me qera Motogenerator 1 cope Pronësi ose me qera Saldatrici 1 cope Pronësi ose me qera Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë: - Kokore minimumi 40 copë - Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë - Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë - Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë - Kulle ndricimi – 1 cope - Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë o) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes. p) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre. q) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj. r) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit. s) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese). t) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi). u) (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 07.09.2018 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur. Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni nje shkrese prane Drejtorise se Prokurimit UKT sha. Operatori Ekonomik “Dajti Park 2007” shpk ka deklaruar në shtojcën nr.10 se disponon mjetet e mëposhtëme: 1. Kamioncine me targa TR4185T me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3.1T 2. Kamion me targa AA042EN me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 15.7 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton) 3. Kamion me targa AA208NE me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 17.1 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton) 4. Kamion me targa AA210NE me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 17.6 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton) 5. Kamioncine me targa AA115KZ me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 3.8T 6. Kamioncine me

targa AA946PU me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 0.6Ton

7. Kamion me targa AA894HH me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 9.8Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)

8. Kamion me targa TR1982M me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 5.5 Ton (do konsiderohet i rregullt dhe do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton )

9. Kamionçinë me targa AA718OA me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.2 Ton

10. Kamionçinë me targa AA213OE me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.1 Ton

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamiona vetëshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 5 ton dhe maximum 10 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri dy kamiona me kapacitetin e duhur nga tre të kërkuar në shtojcën 10/Kriteret e Veçanta të Kualifikimit. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion katër kamionçina kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 1.5 ton dhe maximum 2 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur në përmbushje të këtij kriteri asnjë kamionçinë nga katër të kërkuara. Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionat vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 5 ton dhe maksimumi 10 ton të kërkuar nga AK (3 cope) si dhe është i paplotë lidhur me kamionçinat me kapacitet mbajtës minimumi 1.5 ton dhe maksimumi 2 ton të kërkuar nga AK (4 copë) për rrjedhojë i pavlefshëm Së dyti AK, ka kërkuar gjithashtu në dokumentat standarte te tenderit/kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar: 7.Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të pakten 10 (dhjetë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene: - Grupi I- 3 (tre) punonjës - Grupi II-2 (dy) punonjës - Grupi III- 2 (dy) punonjës - Grupi IV- 2 (dy) punonjës - Grupi V- 1 (nje) punonjës - (Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatëse te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme) Operatori ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur si më poshtë cituar: Për kategorinë e parë ka paraqitur Punonjësit me iniciale L.L, E.B ,XH.Q Për kategorinë e dytë , punonjësit me iniciale R.V, N.S, E.B, I.M, A.LL, I.L, I.S, Për kategorinë e tretë , operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë punonjës duke mos përmbushur në këtë mënyrë kriterin e kërkuar nga AK. Për kategorinë e katërt , punonjësit me iniciale D.K, L.Q Për kategorinë e pestë, punonjësit me iniciale Y.K Pra sa më sipër Shoqëria “ Dajti Park 2007” shpk nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme..... Së treti AK, ka kërkuar gjithashtu në dokumentat standarte te tenderit/kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar: 9.Operatori ekonomik ofertues

duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga te cilet një automakiniste dhe një eskavatoriste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit Operatori ekonomik i mësipërm në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur personat me inicialet e mëposhtme: I.Q (eskavatorist) G.B (eskavatorist) D.K (eskavatorist) I.D( eskavatorist) Nga sa vihet re më sipër operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë punonjës manovrator të paisur me dëshmitë drejtimit për automakinist. Për rrjedhojë dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për të përmbushur kriterin e mësipërm është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.”

II.5. Në datën 08.10.2018 operatori ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 22974/1 Prot. datë 10.10.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” sh.p.k., duke mos pranuar asnjë prej pretendimeve të ngritura prej tij.

II.7. Në datën 19.10.2018 operatori ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

*“[...]Se pari Operatori Ekonomik “Dajti Park 2007” shpk per makinerite e kerkuara nga ana juaj si Autoritet Kontraktor ka paraqitur: Kontrate Noteriale te qerase te specifikuar me emertim objekti me Bajrami-N me makinerite e meposhtme:*

*I(nje) Kamion me targe AA042EN, me kapacitet mbajtes (15.75 ton), (I cili futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton)*

*I(nje) Kamion me targe AA208NE, me kapacitet mbajtes (17.1 ton), (I cili futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton)*

*I(nje) Kamion me targe AA210NE, me kapacitet mbajtes (17.65 ton), (I cili futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 15-20 ton)*

*I(nje) Kamion me targe AA178MB, me kapacitet mbajtes (6.8 ton), (I cili futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)*

*I(nje) Autobetoniere me targe AA081MD,*

*I(nje) Autobetoniere me targe AA082MD,*

*I(nje) Autobetoniere me targe AA726EK,*

*I(nje) Autobot me targe AA180MB,*

*I(nje) Kamioncine me targe AA115KZ,*

*I(nje) Kamioncine me targe AA946PU,*

*Kamioni me targe AA178MB me kapacitet mbajtës (6.8 ton) gjendet ne kontraten Noteriale te qerases te specifikuar me emertim objekti me Bajrami-N qe gabimisht nuk eshte deklaruar ne shtojcen 10 te makinerive por qe shoqeria Dajti Park 2007 shpk ka nenshkruar kontrate qeraje me Bajrami-N duke specifikuar edhe objektin e kontrates. Gjithashtu theksojme se kamioni eshte ngarkuar ne sistemin elektronik te kesaj procedure prokurimi. Per kete arsye te meret ne konsiderate si i rregullt duke permbushur kerkesen e AK per mjetet 5-10 ton. Kontrate Noteriale te qerases te specifikuar me emertim objekti me I. D. me makinerite e meposhtme: Kamion me targa AA894HH me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 9.8Ton (I cili futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton)Fadrome me goma, me targe ACMT35. Kontrate Noteriale te qerases te specifikuar me emertim objekti me N. Z. me makinerine e meposhtme: Kamion me targa TR1982M me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 5.5 Ton (I cili do futet në kategorinë me kapacitet mbajtës 5-10 ton). Kontrate Noteriale te qerases te specifikuar me emertim objekti me H. L. me makinerine e meposhtme: Kamionçinë me targa AA2130E me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.1 Ton. Kontrate Noteriale te qerases te specifikuar me emertim objekti me F. A. me makinerine e meposhtme: Kamionçinë me targa AA718OA me kapacitet mbajtësi cili del nga leja e Qarkullimit e paraqitur për këtë mjet 1.2 Ton. Ne lidhje me kamioninat te kerkuar nga AK (4 copë) Ne si shoqeri kemi paraqitu ne total (5 cope) kamioncina dhe konkretisht: Kamionçinën me targe TR4185T, Kamionçinën me targe AA115KZ, Kamionçinën me targe AA946PU, Kamionçinën me targa AA2130E, Kamionçinën me targa AA718OA, qe ne total e tejkalojne numrin e kerkuar nga AK, keto kamioncina ne tersi i permbushin kriterin e vendosur nga AK. Ne si shoqeri per permbushjen e kontrates kemi paraqitur krahas deklarave edhe grafikun e punimeve qe do i permbahemi dhe do ta permbushim afatin e kerkuar nga ana juaj si AK.*

*Së dyti AK, ka kërkuar gjithashtu në dokumentat standarte te tenderit/kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar: Ne lidhje me piken e kerkuar nga Autoriteti kontmktor se Operatori Ekonomik duhet të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të pakten 10 (dhjetë) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga keta te jene te pakten: Grupi I-3 (tre) punonjës; Grupi II-2 (dy) punonjës; Grupi III-2 (dy) punonjës; Grupi IV-2 (dy) punonjës; Grupi V-1 (nje) punonjës (Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatese te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme). Operatori ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur si më poshtë cituar: Për kategorinë e parë ka paraqitur Punonjësit XH.Q, L.L, E.B. Për kategorinë e dytë , punonjësit me iniciale A.Ll, I.L, L.S, R.V, N.S, E.B, I.M. Për kategorinë e katërt, punonjësit D.K, L.Q Për kategorinë e pestë, punonjësit me iniciale Y.K. Për kategorinë e tretë, operatori ekonomik ka paraqitur punonjësit me inicialet E.XH dhe V.Ç te cilet ndodhen ne dokumentat Dajti Park LIC. DREJT TEKN. LIB.PUNE duke*

*përbushur në këtë mënyrë kriterin e kërkuar nga AK. Pra sa më sipër Shoqëria “ Dajti Park 2007” shpk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke përbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe professional. Prandaj kerkojme nga ana juaj si AK te rishikoje edhe njehere dokumentat dhe te mare parasysh pretendimet e ngritura nga ana jone.*

*Së treti AK, ka kërkuar gjithashtu në dokumentat standarte te tenderit/kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë cituar: Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga te cilet një automakiniste dhe një eskavatoriste. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë per tre muajt e fundit. Operatori ekonomik i mësipërm në përbushje të këtij kriteri ka paraqitur personat me inicialet e mëposhtme: I.Q (eskavatorist) G.B (eskavatorist) D.K (eskavatorist), ndersa punonjesi me inicialet I.D disponon deshmi edhe per (eskavatorist) edhe per (Automakinist) i cili disponon Certificate Aftesimi Profesional me numer serial 0022749 e lëshuar nga DPSHTRR-ja por ju si AK ose nuk e keni vene re ose nuk doni ta veni re. Pra sa më sipër Shoqëria “ Dajti Park 2007” shpk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket personelit të nevojshëm për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke përbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe professional. Prandaj kerkojme nga ana juaj si AK te rishikoje edhe njehere dokumentat dhe te mare parasysh pretendimet e ngritura nga ana jone. [...]*

II.8.Në datën 31.10.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.K-4263/1prot., datë 30.10.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

### **III Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

#### **Arsyeton:**

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : “Operatori Ekonomik ka paraqitur në përbushje të këtij kriteri dy kamiona me kapacitetin e duhur nga tre të kërkuar në shtojcën 10/Kriteret e Veçanta të Kualifikimit. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion katër kamionçina kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 1.5 ton dhe maximum 2 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur në përbushje të këtij kriteri asnjë kamionçinë nga katër të kërkuara.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:



III.1.1.Në pikën 2.2.15 të shtojcës 12, “Për kapacitetin teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

“15.Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 10).

<b>Mjetet</b>	<b>Sasia</b>	<b>Gjendja</b>
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 5(pese) ton dhe maksimumi 10(dhjete) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	1 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma 0.25 m3	1 copë	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës minimum 15(pesëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 20(njëzetë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	1 cope	Pronësi ose me qera
Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pike pese) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	4 cope	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubash PE	1 cope	Pronësi ose me qera
Tokmak elektrik	1 cope	Pronësi ose me qera
Pompe uji	1 cope	Pronësi ose me qera
Matrapik	1 cope	Pronësi ose me qera
Vibrator	1 cope	Pronësi ose me qera
Motogjenerator	1 cope	Pronësi ose me qera
Saldatriçe	1 cope	Pronësi ose me qera

Te paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 40 copë
- Ripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimumi 5 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 5 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Kulle ndricimi – 1 cope
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 15 copë

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet të shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.

- c) Për mjetet e marra me qera të të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.
- e) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).
- f) Makineritë e mësipërme nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar ne procedurat të shpallura fitues nga autoriteti kontraktor, UKT sha. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese ku të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimi).
- g) (opsion) Do të organizohet një vizitë në kantier deri në date 07.09.2018 në mënyrë të tillë që Operatorët Ekonomikë të mund të familiarizohen me kushtet lokale. Operatori i interesuar Ekonomik duhet të konfirmojë paraprakisht me shkrim synimin e tij për të marrë pjesë në këtë vizitë. Gjatë vizitës do t'u jepen informacione shtesë e shpjegime. Të gjitha kostot e Operatorëve Ekonomikë që lidhen me vizitën në kantier duhet të mbulohen nga vetë ata. Pa paragjykuar sa më sipër, dhe me kostot e risqet e veta, një operator ekonomik mund t'a vizitojë në çdo kohë vendndodhjen e kantierit, nëse një gjë e tillë është e mundur.

*Për të organizuar një vizitë në kantier, ju lutem drejtoni një shkresë prane Drejtorise se Prokurimit UKT sha.”*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të këtij kriteri operatori ekonomik ankimes, “Dajti Park 2007” sh.p.k, ndër të tjera, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë Qiraje nr.4420rep, nr.1456kol, datë 20.09.2018, me qiramarrës ”Dajti Park 2007” sh.p.k, objekt i kësaj kontrate, është dhënia me qira e Kamionëve me targë AA042EN; AA208NE; AA210NE; AA178MB dhe Kamiocinave me targë AA115KZ; AA946PU, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
2. Kontratë Qiraje nr.4434rep, nr.1464kol, datë 20.09.2018, me qiramarrës ”Dajti Park 2007” sh.p.k, objekt i kësaj kontrate, është dhënia me qira e Kamioncinës me targë AA718OA, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
3. Kontratë Qiraje nr.4401rep, nr.1452kol, datë 19.09.2018, me qiramarrës ”Dajti Park 2007” sh.p.k, objekt i kësaj kontrate është dhënia me qira e Kamionit me targë TR1982M, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
4. Kontratë Qiraje nr.4436rep, nr.1465kol, datë 20.09.2018, me qiramarrës ”Dajti Park 2007” sh.p.k, objekt i kësaj kontrate është dhënia me qira e Kamionit me targë AA213EO, shoqëruar me dokumentacionin përkatës
5. Kontratë Qiraje nr.4396rep, nr.1449kol, datë 19.09.2018, me qiramarrës ”Dajti Park 2007” sh.p.k, objekt i kësaj kontrate, është dhënia me qira e Kamionit me targë AA894HH, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
6. Shtojcën 10 “Mbi disponimin e makinerive”

III.1.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.1.4. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose 6*
- c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.1.5. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, përkatësisht shtojcën 10 “Mbi disponimin e makinerive”, me anë të së cilës operatori ekonomik ankimues deklaron se zotëron mjetet dhe pajisjet teknike për të realizuar kontratën objekt prokurimi, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për kamionat dhe kamioncinat, referuar dokumentit leje e qarkullimit të mjetit, në të cilin konstatohen të gjitha të dhënat në lidhje me parametrat e mjetit, ndërmjet të cilave edhe kapaciteti mbajtës i tij, në nr. Rendor 23 dhe 24 janë përkatësisht: masa maksimale e autorizuar (kg) dhe Masa e mjetit bosh (kg), evidentohet si më poshtë:

1. Kamioncina me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton:

- Për mjetin me targë AA213EO, kapaciteti mbajtës = 1.13 ton (më pak se 1.5 ton).
- Për mjetin me targë AA718OA, kapaciteti mbajtës = 1.25 ton (më pak se 1.5 ton).
- Për mjetin me targë AA946PU, kapaciteti mbajtës = 0.6 ton (më pak se 1.5 ton).
- Për mjetin me targë AA115KZ, kapaciteti mbajtës = 3.8 ton. (më shumë se 2 ton).

2. Kamiona me kapacitet mbajtës 5-10 ton dhe 15-20 ton:

- Për mjetin me targë AA042EN, kapaciteti mbajtës = 15.7 ton (plotëson 15-20 ton).
- Për mjetin me targë AA208NE, kapaciteti mbajtës = 17.1 ton (plotëson 15-20 ton).
- Për mjetin me targë AA210NE, kapaciteti mbajtës = 17.6 ton (plotëson 15-20 ton).
- Për mjetin me targë AA894HH, kapaciteti mbajtës = 9.8 ton (plotëson 5-10 ton).
- Për mjetin me targë TR1982M, kapaciteti mbajtës = 5.5 ton. (plotëson 5-10 ton).

III.1.6. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik ankimues nuk e përmbush kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për paraqitjen e 4 mjeteve me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton dhe 3 mjeteve me kapacitet mbajtës 5-10 ton. Konstatohet se, në rastin e disponimit të mjeteve me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton, nga mjetet e deklaruara nga operatori ekonomik si kamioncinë në shtojcën 10, për të cilët ka paraqitur edhe dokumentacionin përkatës sipas kërkesave të dokumentave të tenderit, nga 4 mjete të paraqitura asnjë prej tyre nuk e plotëson kapacitetin mbajtës të parashikuar nga autoriteti kontraktor në DST. Ndërsa lidhur me disponimin e mjeteve me kapacitet mbajtës 5-10 ton, nga mjetet e deklaruara nga operatori ekonomik si kamion në shtojcën 10, për të cilët ka paraqitur edhe dokumentacionin përkatës sipas kërkesave të dokumentave të tenderit, ka paraqitur vetëm 2 mjete që plotësojnë kapacitetin mbajtës të parashikuar nga autoriteti kontraktor në DST. Gjykojmë se është barrë e operatorit ekonomik ankimues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekti shqyrtimi, të vërtetojë se disponon kapacitetet teknike në lidhje me mjetet. Sqarojmë se, kriteri për mjetet duhet parë dhe vlerësuar në tërësinë e tij, me të gjithë elementët e kërkuar dhe përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi, referuar mangësive dhe pasaktësirave të konstatuara në dokumentacion nuk arrihet të plotësohet tonazhi i kërkuar i mjeteve, parë kjo në këndvështrimin e vlerësimit të të gjitha të dhënave të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Komisioni thekson se mjetet të cilat nuk deklarohen në shtojcën përkatëse mbi disponimin e makinerive, nuk mund të konsiderohen të vlefshme, pavarësisht dokumentacionit të paraqitur, pasi vetë operatori ekonomik nuk e deklaron atë si të disponueshëm për zbatimin e kontratës objekt-prokurimi. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në rastin konkret, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Në këto kushte, KPP gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.2.15 të shtojcës 12, “Për kapacitetin teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nuk mund të konsiderohet i përmbushur, ndërkohë që mjetet e paraqitura nga operatori ekonomik ankimues nuk përmbushin kushtet e kriterit, përse i takon disponimit të 4 mjeteve me kapacitet mbajtës 1.5-2 ton dhe 3 mjeteve me kapacitet mbajtës 5-10 ton.

III.1.7. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

III.1.8. K.P.P. gjykon se në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kërkesën e mësipërme të autoritetit kontraktor, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës mbi hartimin e dokumenteve dhe kritereve të veçanta të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*. Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimin të kritereve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“[...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Dajti Park 2007” sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë pasi operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

**Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Dajti Park 2007” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt, “*Ndërtim rrjet furnizimi me ujë i zonës së "Bab Rexhës", Fusha e Aviacionit*”, me nr. REF-82943-08-14-2018, me fond limit 38,513,055 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 25.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1623 protokoli Datë 19.10.2018**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Wilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**